



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: “ Hysen Sopa B.I.”emri i biznesit / N.N.SH. “EMSA”emri tregtar, me seli në Suharekë, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën 10.06.2020, merr këtë:

## **V E N D I M**

- 1. Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e pasuksesshëm të subjektit në procedurë: “ Hysen Sopa B.I.”emri i biznesit / N.N.SH. “EMSA”emri tregtar, me seli në Suharekë, në procedurën e prokurimit me titull: “ Ndërtimi i kiosqeve në Sheshin Adem Jashari “ Nr.i prokurimit: VU644 – 20 – 771 – 5-2-1 e Nr. i brendshëm: 644-20-010-521.
- 2. Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 01.06.2020

## **A r s y e t i m**

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ( në tekstin e mëtejme A.K. ) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që ta rekomandoi për dhënie të kontratës Grupin e Op. Ek.: “ Mazreku ”sh.p.k. & “AAB Contruction” sh.p.k. me seli në Malishevë ndërsa, O.E.: “ Hysen Sopa B.I.”emri i biznesit / N.N.SH. “EMSA”emri tregtar, me seli në Suharekë ( në tekstin e mëtejme Ankuesin) ta renditë në mesin e O.E. të pasuksesshëm, bazuar në procedurën e zbatuar.

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e pasuksesshëm për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. 01.06.2020, bazuar në dispozitat e nenit 43 të Rregullores mbi Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se A.K. duke vendosur si në Vendimin e dt. 01.06.2020 ka shkelur dispozitat e LPP-së , konkretisht: nenin 1-Qëllimi, nenin, nenin 6- Ekonomiciteti dhe efikasiteti, neni 7–Barazia dhe Trajtimi, nenin 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve dhe nenin 39 pika 39.3 dhe 4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, më tej ( ROUPP ).

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtuara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë, për arsye se:

1. Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Neni 33 paragrafi 1 ( Procedurë e Hapur ) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 60 paragrafi 1 pika 1.1 ( tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët ) ka pasur për qëllim që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimit dhe vlerësimi të tenderëve,

bazuar në nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 “ Kriteret e Dhënies së Kontratës “ të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 01.06.2020 është marrë bazuar në kushtet , rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së, vendimi, sikurse ka vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar nga interesat personale, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent, duke përfshirë këtu edhe të drejtën Ankuesit për të realizuar qasjen në dokumente të tenderit. Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik: **“ Mazreku ”sh.p.k. & “AAB Contruction” sh.p.k. me seli në Malishevë “** është marrë në mes tjerash edhe në zbatimin e nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përmbushë minimalisht kërkesat e përzgjedhjes të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.
3. Kërkesat minimale të kualifikimit, të cilat së bashku dhe me Kriteret e përshtatshmërisë karakterizohen edhe si Kriteria të Përzgjedhjes, të saktësuara si në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, sikurse ka vlerësuar A.K., janë proporcionale dhe në harmoni me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve dhe / ose furnizimeve të cilat janë lëndë e aktivitetit të prokurimit në fjalë, e që është në pajtim dhe me nenin 51 të LPP-së sa i përket Kriteriave të përzgjedhjes. Pretendimi i Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës dhe O.E. “ Kopshti “sh.p.k. si O.E. i pasuksesshëm janë të papërgjegjshëm sepse nuk posedojnë referencë ose raport të pranimit të punëve dhe / ose furnizimeve të njëjta është i pasaktë, sepse në pikën 1 të nenit 9.1 lidhur me 9.2 të Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale është saktësuar decidivisht **“ Projekte të përfunduara të punëve apo furnizimeve të ngjashme (përpunim i drurit) në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimum një projekt të realizuar „ me çka A.K. ka vlerësuar se si O.E. i rekoamnduar për dhënie të kontratës ashtu edhe O.E. i ranguar si i pasuksesshëm, bazuar në dëshmitë e dorëzuara, posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike dhe / ose profesionale si në kuptim të vlerës së parashikuar të kontratës ashtu edhe në kuptim të përdorimit të drejtë të fondeve publike. Pikërisht, pretendimi i O.E. që si kriter i përzgjedhjes të merret “ projekti i njëjtë apo referenca për punë/furnizim të njëjtë “ paraqet shkelje të nenit 6 dhe 7 të LPP-së, sepse ndaj O.E. do të paraqiste kërkesë kufizuese për pjesëmarrje në tender, do ti trajtonte O.E. në mënyrë të pa barabartë dhe diskriminuese, prandaj mbi këtë bazë A.K. e ka refuzuar si të padrejtë dhe të paligjshëm një pretendim të tillë të Ankuesit. Sikurse ka vlerësuar A.K., gjatë procesit të vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, si grupi i O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës ashtu edhe O.E. “ Kopshti” sh.p.k., përmes Listës së projekteve të përfunduara bashkangjitur dhe kontratën e punës ose referencës ose raportit të pranimit, kanë dëshmuar pa diskutueshëm se kanë realizuar punë dhe / ose furnizime të ngjashme me natyrën e aktivitetit të prokurimit në fjalë gjatë tre viteve të fundit, sikurse janë: ndërtim i objekteve ku parashihet edhe konstrukcion i kulmit nga punimi i drurit, riparim i kulmit me konstrukcion druri, ndërtim i kioskut e disa punë tjera të ngjashme. Përmes këtyre dëshmimeve A.K. ka vlerësuar se O.E. kanë përmbushur kërkesat e saktësuara në Fleta e të Dhënave të Tenderit ( FTD ) saktësisht pika 1 e nenit 9.1 lidhur me 9.2 të Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale.**
4. Ndërsa sa i përket pretendimit të Ankuesit se A.K. ka shkelur nenin 52 të LPP-së lidhur me Kriterin për Dhënie të Kontratës, A.K. konstaton padiskutueshëm se dispozita e nenit 52 është respektuar në plotni pasi që A.K. ka vendosur dhe rekomanduar për dhënie të kontratës Grupin e O.E. **“ Mazreku ”sh.p.k. & “AAB Contruction” sh.p.k. me seli në Malishevë “** pikërisht mbi bazën e kriterit të dhënies së kontratës të përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, dmth: **“ tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët “**. Mbi këtë vlerësim, konstatimi i Ankuesit se ai është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit në fjalë me çka është dëmtuar buxheti i A.K. , sikurse thekson në Kërkesë, për 13.932,20, është jo vetëm i pasaktë por edhe i pa kuptim kur kemi parasysh faktin se Ankuesi nuk është eliminuar si i

papërgjegjshëm në këtë aktivitet, nuk ishte O.E. me çmimin më të ulët, por është radhitur në mesin e O.E. të pasuksesshëm që është dallim substancial. Po ashtu edhe konstatimi se është dëmtuar buxheti i A.K. është i pasaktë kur kemi parasysh se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës është radhitur si O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët, andaj pretendimi i Ankuesit se në këtë proces është shkelë parimi i ekonomicitetit dhe efikasitetit është i paargumentuar dhe për rrjedhojë i pabazuar për faktin se Vendimi i A.K. është marrë vetëm pas shterimit të të gjitha procedurave që kanë të bëjnë me nenin 59 të LPP-së dmth vetëm pasi është bërë vlerësimi dhe ekzaminimi i të gjithë dokumentacionit tenderik të dorëzuar prej O.E. pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit në fjalë.

5. Po ashtu është me interes të sqarohet se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve respektivisht vlerësimi i dëshmimeve të dorëzuara në dosjen e tenderit dhe marrja e Vendimit mbi bazën e vlerësimit të dëshmimeve të dorëzuar është marrë në pajtim të plotë me nenin 39.3 dhe 39.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik sa i përket kërkesave lidhur me marrjen e informacioneve dhe / ose dokumenteve shtesë të cilat eventualisht mungojnë në dosjen e tenderit.
6. Në fund A.K. më tej vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit për të përzgjedhur për rekomandim me dhënie të kontratës të O.E.: “ **Mazreku** ”sh.p.k. & “ **AAB Contruction** ” sh.p.k. me seli në Malishevë “ nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, konkretisht neni 1-Qëllimi, neni 6- Ekonomiciteti dhe efikasiteti sepse është rekomanduar O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët, neni 7–Barazia dhe Trajtimi sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo-barabar apo diskriminuese, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 52 parag. 4 – Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës, neni 54 parag. 1 dhe 2 – Njoftimi i kandidatëve dhe tenderuesve të pasuksesshëm, neni 56 parag. 3 – Përzgjedhja e pjesëmarrësve dhe dhënia e kontratës, neni 59 parag.4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, neni 60 – Kriteret e Dhënies, neni 69 – Aftësia Teknike dhe Profesionale dhe neni 72 Dokumentet dhe Informatat shtesë, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K., janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
K.R. nr. 010/2020 - datë 10/06/2020

Vendimi i dërgohet:

Drejtoria për Prokurim Publik

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkiviti (1 kopje)

  
Hyda Dallku-ZPP